

MNN QENDRORE



MISIONET NDËRKOMBËTARE NAZARETASE

24 Dhjetor 2025

NJË SHIKIM I SHPEJTË MNN



Dita e Krishtlindjes: DRITA



Kjo është rubrika e pestë e Adventit dhe Krishtlindjes që reflekton mbi Deklaratën e Identitetit të MNN-së dhe Pesë Fushat e Ndikimit të MNN-së.

MNN është avokati i misioneve globale në çdo kishë lokale, që ushqen një frymë misionare dhe mobilizon në veprim, duke ndikuar te njerëzit anembanë botës.

Çfarë do të thotë të ‘ndikosh tek njerëzit anembanë botës’? Do të thotë të bëjmë pjesën tonë, si brenda ashtu edhe përtej kontekstit tonë të kufizuar; të japim, të dërgojmë dhe të shkojmë në botë. Me çdo dhuratë që japim, në çdo përpjekje që ndërmarrim, Drita vazhdon të ndriçojë mbi errësirë. Jetët ndryshojnë, shoqëritë transformohen. Ne bashkohemi me engjëjt e Krishtlindjes, duke kënduar: “Krishti, Shpëtimtari u lind!”

Adventi kulmon me një agim të shumëpritur, ardhjen e Birit, një Foshnje. Lindja e tij shpesh paraqitet në një skenë e Lindjes së Krishtit, prej së cilës buron DRITA nga një grazhd i thjeshtë. Në këtë natë, DRITA ndriçoi mbi errësirën dhe i Përjetshmi erdhi midis nesh. Ne, që jemi mbushur me atë Dritë të Përjetshme, nuk mund ta mbajmë vetëm për vete. Kudo që shkojmë, në çdo gjë që bëjmë, Drita e Tij brënda nesh dhe duke vepruar përmes nesh duhet të sjellë ndryshim.



Prioriteti i MNN-së: Dhënia për Fondin e Ungjillizimit Botëror (FUB), si një shprehje mirënjohjeje dhe administrimi besnik i gjithçkaje që Krishti na ka dhënë, sjell një ndryshim të madh në botë. Misionet vazhdojnë të sjellin transformim, dhe përmes dhënies për FUB, ne e DRITËN e Krishtit në çdo vend të errët ku njerëzit përpiqen të shohin një shkëndijë SHPRESË; të gjejnë PAQË në mes të konflikteve; të njohin GËZIMIN e faljes së mëkateve; të përjetojnë DASHURINË që na ndryshon me mirësi, sepse ne marrim pjesë në misionin e Perëndisë në botën tonë të thyer.

KALEIDOSKOP PËR FËMIJË



Ai është këtu! Gëzuar ditëlindjen Jezus, dhe Gëzuar Krishtlindjet! Ai zbriti nga qielli dhe hyri në këtë botë kaq të ndryshme. Ai është dritë në errësirë. Ne jemi të thirrur të jemi si Ai. Perëndia i thërret misionarët të shkojnë dhe të shkëlqejnë dritën e Tij në vendet e errëta të kësaj bote. Po ju, si jeni dritë në vendin ku Perëndia ju ka vendosur? Për të mësuar më shumë, [klikoni këtu](#) për të shkarkuar pjesën tjetër të Kaleidoskopit për Fëmijë për Ditën e Krishtlindjes.

Kërkesa për Lu tje

- Lutuni që Kisha në mbarë botën të për qafojë thirrjen e Krishtit për t'u bashkuar me Të në mision, qoftë duke u lutur, duke dhënë apo duke shkuar.
- Lutuni për misionarët Nazaretas dhe të tjerët që ndajnë Krishtin, Dritën e Botës, me ata që ende nuk e kanë takuar Atë.



Lavdërime

- Lavdëroni Perëndinë për Nazaretasit në mbarë botën që kanë dhënë për Fondin e Ungjillizimit Botëror për të përhapur Dritën e Ungjillit.
- Lavdëroni Zotin për çdo mundësi për t'i drejtuar të tjerët tek Ai dhe ndaluni dhe falënderoni atë që ju drejtoi tek Ai.



A MUND TË SHËRBESH?

A po ju thërret Zoti të merrni pjesë në misionin e Tij?
Për më shumë informacion, **[klikoni këtu](#)**.

MNN Qendrore është i disponueshëm në një arkiv PDF të zgjeruar.
Për të lexuar botimet e mëparshme, **[klikoni këtu](#)**.



KISHA  NAZARENIT
MISIONET NDËRKOMBËTARE
NAZARETASE